

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7918
E mërkurë, 30 tetor 2024
Çmimi 0.50 €

Albini po ballafaqohet me pengesat politike që i ka ngritur vetë | FAQE 6



Shkruan: Hajdin ABAZI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

TRE MUAJ PARA ZGJEDHJEVE, KURTI MERR VENDIM PËR RRITJEN E PAGAVE NË SEKTORIN PUBLIK | FAQE 4-5



Kryeministri i vendit, Albin Kurti, ka paralajmëruar rritjen e pagave në sektorin publik nga janari i vitit 2025. Kurti ka bërë me dije se vlera e koeficientit do të mbetet 110 euro,

por do të rritet koeficienti për 1 njësi, gjysmë njësie në janar dhe gjysmë në korrik. "Shprehur në vlerë monetare, i bie që të gjithë të punësuarit në sektorin publik, pagat

për ta do të rriten për 55 euro duke filluar nga janari, dhe për 110 euro nga muaji korrik i vitit të ardhshëm 2025", ka thënë Kurti në konferencën për medie

LAJÇAKU SHPREH OPTIMIZËM PËR PËRPARIMIN NË DISA TEMA TË DIALOGUT | F. 3



KOSOVA DHE ARABIA SAUDITE, MARRËVESHJE PËR NISJEN E LINJAVE AJRORE DIREKTE | F. 3



AKTUALE



LETRA E ALI AHMETIT, RUAJTJE E STABILITETIT A LËVIZJE E PANEVOJSHME? | F. 2

SINDIKATAT ANKOHEN PËR MOSFUNKSIONIMIN E KËSHILLIT EKONOMIKO-SOCIAL, IKD-ja PARALAJMËRON PADI NDAJ MF-së | F. 6

KURTI: UNË S'MUND TË THEMELOJ ASOCIACION TË KOMUNAVE SI KRYEMINISTËR | F. 3

EKONOMI



PARAQITET SKEMA E GRANTEVE, PECI: JEMI TË ANGAZHUAR PËR T'I FUQIZUAR FERMERËT DHE SIPËRMARRËSIT TANË | F. 6

ZKA-ja DHE KLSH-ja ANGAZHohen PËR PËRMIRËSIMIN E AUDITIMIT PUBLIK NË KOSOVË DHE SHQIPËRI | F. 7

SPORT



BALLKANI NDALET NË BARAZIM NGA GJILANI, SOT ZHVILLOHEN DY NDESHJE | F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
838 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Letra e Ali Ahmetit, ruajtje e stabilitetit a lëvizje e panevojshme?

SHKUP, 29 TETOR - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim në opozitë (BDI), Ali Ahmeti, pas letrës së dërguar liderëve të lartë shqiptarë dhe ndërkombëtarë, ku shprehu shqetësimin për mosrespektimin e Marrëveshjes së Ohrit, të hënën me një letër të ngjashme i është drejtuar edhe kreut të qeverisë maqedonase, Hristijan Mickoski, lidhur me vendimet e fundit të Gjykatës Kushtetuese.

Njohësit e çështjeve politike në Maqedoninë e Veriut kanë mendime të ndryshme sa i përket letrës së Ahmetit. Disa e shohin këtë veprim si paralajmërim për ruajtjen e stabilitetit të brendshëm të vendit, ndërsa të tjerë e cilësojnë si një lëvizje të panevojshme.

Në letrën drejtuar Mickoskit, kreu i BDI-së, Ahmeti, thekson se vendimet për heqjen e mekanizmeve mbrojtës për komunitetet (Balancuesi) dhe "planet për ndryshimet në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve" jo vetëm që janë politikisht të diskutueshme por, njëkohësisht, janë "shumë të rrezikshme dhe të dëmshme për përpërimin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë".

Analisti dhe botuesi i një gazete në Maqedoninë e Veriut, Arben Ratkoceri, thotë për Radion Evropa e Lirë se situata aktuale është delikate dhe kërkon kujdes të veçantë. "E dimë se sa sensitiv është rajoni, si dhe Maqedonia e Veriut, përballë krizave globale që po ndodhin. Inercia e këtyre krizave dhe faktorët e tjerë globalë mund ta shfrytëzojnë situatën për ta destabilizuar minimalisht rrafshin politik të Maqedonisë së Veriut, për të mos thënë atë të sigurisë", thotë Ratkoceri.

Por, kështu nuk mendon edhe Zoran Ivanov, gazetar dhe komentues i çështjeve politike në Maqedoninë e Veriut. "Nuk mund të vlerësoj, por konsideroj se fjala është për sueta (diçka të ekzagjeruar). Nuk po them se për disa punë, dhe për këtë temë, nuk ka të drejtë (ai - Ali Ahmeti) por, prapëseprapë, mendoj se më të afërmit e tij, nga partia, duhet të gjejnë një mënyrë që t'i sugjerojnë se historia me zgjedhjet e majit ka përfunduar", thotë për Radion Evropa e Lirë, Ivanov.

Ai i konsideron letrat e Ahmetit si një "e shtënë me barut të lagur". "Shansi, edhe për të (Ali Ahmetin), edhe për BDI-në, për t'u rikthyer në portën fituese dhe për ta rikthyer autoritetin e tij të padiskutueshëm deri para një kohe, në elektoratin shqiptar, është te fjala e votuesve që duhet ta thonë në zgjedhjet lokale të vitit



të ardhshëm. Këtu, edhe ai (Ali Ahmeti), edhe partia, duhet ta harxhojnë energjinë e tyre politike", konsideron Ivanov. "Mendoj se kjo me letrat është vetëm e shtënë me barut të lagur". Ahmeti në letër gjithashtu paralajmëron se në situatën aktuale gjeopolitike, të cilën ai e cilëson si më të rrezikshme që nga fundi i shekullit të kaluar, çdo tension i ri në marrëdhëniet ndëretnike do të ketë "pasoja të rënda për kohezionin e brendshëm dhe stabilitetin e vendit". Ai i bën thirrje Mickoskit të "mendojë me pjekuri dhe përgjegjësi" dhe thotë se e ardhmja e vendit duhet të ndërtohet në bazë të bashkëpunimit dhe respektit të ndërsjellë, e jo me ndarje. "Situaata gjeopolitike është më e rrezikshme se në çdo kohë që nga fundi i shekullit të kaluar, me përshkallëzimin e agresionit rus në Ukrainë, ambiciet e Kinës, situatën komplekse në Ballkanin Perëndimor, paqëndrueshmërinë në Bosnjë-Hercegovinë, tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dhe bllokadat e vazhdueshme nga ana e Bullgarisë. Në këtë mjedis të komplikuar, çdo prishje e re e marrëdhënieve ndëretnike do të kishte pasoja të rënda për kohezionin e brendshëm dhe parashikimin", thuhet në letrën e Ahmetit drejtuar kreut të qeverisë maqedonase.

Në këtë kontekst, Ratkoceri

termin "pasojë" e përshkruan si shumëdimensional. "Ndoshta reflekton në proceset ose shprehjet demokratike të një moskënaqësie në një pjesë të shoqërisë", shprehet ai. "Rajoni funksionon si një efekt domino, prandaj z. Ahmeti, si një politikan me përvojë në këto procese, mendoj se po përpigjet ta mbajë këtë pakënaqësi brenda një kornize të debatit të brendshëm politik dhe ta parandalojë përkeqësimin e situatës përmes këtyre formave", konsideron Ratkoceri.

Ndërkohë, për letrën e Ahmetit, kryeministri Mickoski u përgjigj shkurt. "Jo, nuk e kam parë. Unë çdo ditë marr shumë letra, dhe i lexoj me kujdes. Marr shumë porosi dhe me kujdes të madh i qasem çdo komunikimi me qytetarët. Z. Ahmeti është qytetar, dhe duhet t'i kushtoj vëmendje çdo letre nga çdo qytetar. Kur ta lexoj, do të jap komentim tim", tha të hënën Mickoski derisa po merrte pjesë në inspektimin e ndërtimit të segmentit Gostivar - Bukojčan, pjesë e Korridorit VIII. Ndërsa zëvendëskryeministri i parë, Izet Mexhiti, nga koalicioni VLEN, pjesë e qeverisë maqedonase, e cilësoi letrën e Ahmetit si "boshe".

Ahmeti ditë më parë u dërgoi letrë edhe udhëheqësve të lartë shqiptarë (presidentit dhe kryeministrit të Shqipërisë, Bajram Begaj dhe Edi Rama,

presidentes dhe kryeministrit të Kosovës, Vjosa Osmani dhe Albin Kurti) dhe atyre ndërkombëtarë (presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, kancelarit gjerman Olaf Scholz, presidenti francez Emmanuel Macron dhe sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken). Sipas BDI-së, letrat e dërguara nga Ahmeti adresuan tri vendime të fundit: shfuqizimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, ndalimin e identifikimit etnik në institucionet shtetërore dhe formimin e një qeverie pa përfaqësim të drejtë etnik. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut pritet të vendosë në dhjetor lidhur me fatin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, i cili është miratuar shtatë vjet më parë.

Kryeministri Mickoski tha më 26 tetor se nuk kontestohet i gjithë ligji, por vetëm dy-tri dispozita. Me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në institucionet shtetërore në Maqedoninë e Veriut përdoren si gjuhë zyrtare ato gjuhë që fliten nga të paktën 20% e qytetarëve të vendit. Kjo përfshin gjuhën shqipe, e cila përmendet si gjuha e një pjese të konsiderueshme të popullatës dhe përkufizohet në nenin e parë të këtij ligji. Gjithashtu, ligji siguron përdorimin e gjuhëve të tjera të komuniteteve me përfaqësim më të vogël se 20%. Më 9 tetor Gjykata Kushtetuese në

Maqedoninë e Veriut vendosi ta shfuqizojë Balancuesin, një mekanizëm softuerik që rregullonte përfaqësimin "e drejtë dhe adekuat" të komuniteteve etnike në administratën publike. Nga BDI-ja shfuqizimin e Balancuesit e cilësuan si ndërhyrje në Marrëveshjen e Ohrit.

Ky mekanizëm ishte krijuar për ta zbatuar Marrëveshjen e Ohrit të vitit 2001 dhe sigurote që përqindja e punësimeve të përputhej me përbërjen etnike të popullsisë.

Si përgjigje ndaj shfuqizimit të Balancuesit, koalicioni shqiptar VLEN, që është pjesë e qeverisë maqedonase, ka njoftuar se është duke hartuar "ligjin për përfaqësim të drejtë dhe adekuat". Por, pavarësisht prej këtij pohimi të koalicionit VLEN, ministri i Administratës Publike, Goran Minçev ka deklaruar se ende nuk e ka parë draft-versionin e koalicionit "VLEN". "Jo, ende nuk është formuar grupi i punës, por jam i sigurt se qeveria ka kapacitet dhe mundësi politike për të arritur një zgjidhje serioze, sistematike dhe cilësore. Nuk ka nevojë për nxitim. Duhet të kemi durim, sepse kemi pasur edhe situata kur nga viti 2001 deri në vitin 2015 nuk ka pasur 'balancues', por është zbatuar kategoria kushtetuese, përfaqësimi i drejtë i bashkësive etnike", tha të hënën ministri Minçev.

Haradinaj paraqet planin për anëtarësimin e Kosovës në NATO

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 TETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se plani dhjetëvjeçar, në pajtim me Amerikën dhe NATO-n, është themeli për veprimin e ardhshëm, anëtarësimin e drejtpërdrejtë në NATO. Ai ka bërë me dije se Partneriteti për Paqe tashmë është realizuar përmes këtij plani. "Tani Kosova synon anëtarësimin e plotë në NATO përmes një plani të ri që përfshin tri aspekte kryesore: 1. Politik: Forcimi i marrëdhënieve me institucionet euroatlantike; Përmeshja e obligimeve në dialog; Konsolidimi i demokracisë në Kosovë; Përmirësimi i marrëdhënieve me fqinjët. 2. Ushtarak: Ngritja e kapaciteteve luftarake të Ushtrisë së Kosovës; Zhvillimi i industrisë

mbrojtëse vendore; Prodhimi i municioneve, predhve dhe pajisjeve të tjera ushtarake; Përmirësimi i infrastrukturës ushtarake dhe mbrojtëse civile; Rritja e kontributit të Kosovës në angazhimet e NATO-s. 3. Ekonomik: Aktivizimi i resurseve të Kosovës për partneritet ekonomik me vendet e Aleancës", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Lideri i AAK-së ka theksuar se anëtarësimi në NATO do të sjellë përfitime të shumta. "Do të jetë kthesa më e madhe e sigurisë për Kosovën; Do të garantojë zhvillim ekonomik duke rritur vlerën e resurseve dhe potencialeve të vendit; Do të inkurajojë investitorët vendas dhe të huaj; Do ta shndërrojë Kosovën në një adresë të rëndësishme ekonomike", ka thënë ai, duke shtuar se kjo kthesë e madhe ekonomike do ta sigurojë



qëndrimin e qytetarëve, veçanërisht të rinjve në Kosovë, përmirësimin e sistemit shëndetësor, duke ofruar shërbime cilësore për të gjithë, ngritjen e cilësisë së arsimit në nivelin e vendeve të NATO-s dhe përshtatjen e arsimit me nevojat e tregut të punës. "Aleanca hyn në zgjedhje me vizionin e kësaj kthese të madhe në siguri dhe ekonomi. Ky vizion synon të sigurojë: Paga dhe pensione të dinjitetshme për qytetarët; Kushte më të mira jetese; Zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha sferat. Udhëheqja nacionale kërkon vizion të gjerë. Anëtarësimi në NATO është përgjigje për zhvillimin e përgjithshëm të vendit, duke përfshirë qëndrimin e popullatës, përmirësimin e arsimit dhe shëndetësisë, si dhe sigurimin e pagave të dinjitetshme", ka theksuar Haradinaj.

Lajçaku shpreh optimizëm për përparimin në disa tema të dialogut

PRISHTINË, 29 TETOR - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, ka thënë të martën se ndien optimizëm për pak përparim të arritur në disa çështje me rëndësi gjatë një takimi të kryenegociatorëve javën e kaluar në Bruksel.

Kryenegociatori i Kosovës dhe ai i Serbisë, Besnik Bislimi dhe Petar Petkoviç, nuk arritën pajtueshmëri për mënyrën se si të ecet përpara në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve fqinje gjatë takimit të tyre trepalësh me Lajçakun të enjten në Bruksel, por u pajtuan për disa çështje të tjera.

Lajçaku shkroi të martën në "Facebook" se, derisa nuk u arrit ndonjë rezultat për rrugën drejt zbatimit të Marrëveshjes së vitit 2023, "jam optimist për



pak përparim të arritur në disa çështje të rëndësishme, për të cilat do të vazhdojmë punën në javët në vijim".

Pas takimeve të së enjtes, Bislimi njoftoi se palët ishin pajtuar për disa çështje, përfshirë themelimin e një

grupi punues, i cili do t'i harmonizojë rreth 20 certifikata veterinerë të cilat përdoren për kalimet kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kosova e ka akuzuar Serbinë në të kaluarën se i ka penguar mallrat dhe bizneset e Kosovës

që kalojnë transit nëpër territorin e Serbisë, pasi Beogradi nuk nje certifikatën fitosanitare të lëshuar nga Republika e Kosovës. Ai tha se Lajçaku i njoftoi gjatë takimit se Serbia është zotuar se deri në fund të muajit të ardhshëm do të lëshohen linjat e interkoneksionit, që ka qenë marrëveshje e energjisë e vitit 2022.

Takimi i së enjtes ishte i pari trepalësh pas më shumë se tre muajve mes Bislimit dhe Petkoviçit, por ata përsëri dështuan të arrijnë pajtueshmëri për mënyrën se si të ecet përpara në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve fqinje.

Duke folur pas takimit, Bislimi tha se në fokus të takimit ishte gjetja e një mënyre për zbatimin e plotë të Marrëveshjes Bazë, për të cilën

Kosova dhe Serbia u pajtuan në fillim të vitit 2023. "Fatkeqësisht për temën kryesore që jemi mbledhur nuk ka rezultat. Serbia me gjasë ende po ngul këmbë në zbatim të pjeshëm, pra sipas idesë, 'ne bëjmë diçka ju bëni diçka'", tha Bislimi.

Kryenegociatori serb Petkoviç tha se Beogradi "nuk po ikën" nga detyrimet që dalin nga Marrëveshja Bazë, por se Prishtina duhet të jetë e para që do të fillojë, duke nisur me themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Kosova ngul këmbë se kjo marrëveshje duhet të nënshkruhet së pari, edhe pse BE-ja thotë se ajo është detyruese për palët pavarësisht nënshkrimit, dhe e ka akuzuar Serbinë edhe në të kaluarën se dëshiron vetëm zbatimin e pjeshëm të saj.

Kurti: Unë s'mund të themelohet asociacion të komunave si kryeministër

Prishtinë, 29 tetor - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të martën se ai si kryeministër i vendit nuk mund ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, i cili është ndër kërkesat kryesore ndaj Kosovës sipas një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve mes saj dhe Serbisë.

Duke folur në një konferencë për medie në Prishtinë, Kurti tha se ai, megjithatë, kishte shprehur gatishmërinë ta nënshkruante një draft-statut për Asociacion në mars 2023 në Ohër, kur Kosova dhe Serbia

kishin arritur pajtueshmëri për aneksin e Marrëveshjes Bazë. "Unë kam ofruar ta shkruaj draft-statutin më 18 mars 2023 në Ohër, por jam refuzuar. Por, në anën tjetër, më lejoni të theksoj se jam kryeministër i republikës demokratike. Meqë Kosova është republikë demokratike, kryeministrat nuk formojnë asociacione komunash", tha Kurti.

Ai tha se themelimi i një asociacioni nuk duhet të jetë i imponueshëm dhe se Kosova tashmë e ka një asociacion komunash, duke iu referuar Asociacionit të Komunave të

Kosovës. "Komunat asociohen me njëra-tjetrën, koordinohen e bashkëpunojnë. Ju e dini se ne tashmë e kemi një Asociacion të Komunave të Kosovës. Nëse dikush e dëshiron një asociacion tjetër, atëherë ai duhet të vijë nga dikush tjetër. Nëse kryeministri do ta themelonte atë, asociacioni do të ishte imponim ndaj komunave", theksoi ai.

Ai ngul këmbë se themelimi i asociacionit duhet të jetë zgjedhje "e lirë dhe e drejtë" "Dhe, këtë s'e bëj unë, aq më pak një shtet fqinj", tha Kurti duke iu referuar Serbisë.



Vitin e kaluar Kosova dhe Serbia e pranuan Marrëveshjen drejt normalizimit të marrëdhënieve, e një nga pikat

e saj kërkon që komunitet serb në Kosovë t'i ofrohet një nivel i caktuar i vetëmenaxhimit, përkatësisht Asociacioni.



Tre muaj para zgjedhjeve, Kurti merr vendim për rritjen e pagave në sektorin publik

Kryeministri i vendit, Albin Kurti, ka paralajmëruar rritjen e pagave në sektorin publik nga janari i vitit 2025. Kurti ka bërë me dije se vlera e koeficientit do të mbetet 110 euro, por do të rritet koeficienti për 1 njësi, gjysmë njësie në janar dhe gjysmë në korrik. “Shprehur në vlerë monetare, i bie që të gjithë të punësuarit në sektorin publik, pagat për ta do të rriten për 55 euro duke filluar nga janari, dhe për 110 euro nga muaji korrik i vitit të ardhshëm 2025”, ka thënë Kurti në konferencën për medie

Kurti shpjegoi se “duke filluar nga janari i vitit të ardhshëm koeficienti do të rritet për 0.5 njësi, pra për gjysmë njësie dhe pastaj nga korriku 2025 edhe për 0.5 njësi të tjera. Pra, dikush që e ka koeficientin 5.6, në janar i bëhet 6.1, kurse në korrik 6.6. Ngjashëm edhe për dikë që e ka koeficientin 10.5, në janar i bëhet 11 dhe pastaj 11.5”.

Ai tha se rritja e dytë e pagave për 55 euro të tjera do të bëhet verën e ardhshme, por vendi do të shkojë në zgjedhje të reja parlamentare në shkurt 2025. “Me fjalë të tjera, pagat për të gjithë të punësuarit në sektorin publik do të rriten për 55 euro duke filluar nga janari dhe për 110 euro nga korriku 2025. Kështu, rritjen buxhetore e shpërndajmë proporcionalisht tek ata që kanë paga më të ulëta, duke zvogëluar hendekun mes pagës më të ulët dhe asaj më të lartë”, tha ai. Ai tregoi se qeveria e tij ka planifikuar buxhet për shpenzim për vitin e ardhshëm në vlerë mbi 3.6 miliardë euro, që është më shumë se buxheti i vitit të kaluar prej 3.3 miliardë eurosh.

Nga kjo rritje do të përfitojnë

mësimdhënësit, policët, ushtarët, infermierët dhe zjarrfikësit, të cilëve do t’u rriten pagat për 18 deri 20 për qind, sipas Kurtit.

Për pagat më të larta, tha ai, rritja do të jetë 6-7 për qind. Kjo rritje e paralajmëruar nga ai do t’i kushtojë buxhetit rreth 120 milionë euro në vit, sipas Kurtit.

Ky njoftim i Kurtit u bë vetëm rreth dy muaj pasi qeveria e tij i rriti për 20 për qind pensionet që financohen nga shteti. Rritja e pensioneve hyri në fuqi në tetor.

Ai, gjithashtu, njoftoi në shtator se pensionet e përcaktuara me Ligjin për Kategoritë e Luftës do të rriten për 20 për qind nga muaji janar 2025.

Ndërkaq ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, tha se ketë rritje pagash e kanë bërë në maksimumin e lejuar sipas ligjit e falë rritjes ekonomike. “Atë buxhet që e kemi pasur në vend që ta shpërndajmë proporcionalisht, pra tek të gjithë me përqindjen e njëjtë, kemi vendosur që ta shpërndajmë në vlerë absolute, ku pastaj nëse përkthehet në

përqindje i bie për disa pozita që kanë paga më të ulëta, rritja në përqindje do të jetë shumë e lartë, ndërsa për pozitat e larta drejtuese rritja mund të jetë 5, 6 apo 7 % varësisht nga niveli i koeficientit”, ka thënë ai.

Murati ka thënë se kësajsoj edhe po e ruajnë qëndrueshmërinë fiskale, por edhe po sigurohen që ata që janë kontribuuesit më të mëdhenj për funksionimin e vazhdueshëm të administratës publike, të shërbimeve publike si mësuesit, zjarrfikësit, policët, ushtarët, administrata publike, pra profesionistët që punojnë këtu, të përfitojnë më së shumti nga kjo rritje. “Gjithsesi, edhe në diskutimet që kemi pasur me partnerët tanë ndërkombëtarë, saktësisht me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ka qenë një negociim i vazhdueshëm që ata t’i bindim, dhe falë disiplinës fiskale dhe maturisë sa iu përket politikave fiskale që kemi treguar në katër vitet e fundit, ka qenë më e lehtë që të binden që të shkojmë me këtë version”, ka thënë ministri Murati.

Edhe Murati ka thënë një shpjegim për rritjen e pagave. “Rritja pra bëhet në dy faza (dy

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha të martën se qeveria ka vendosur t’i rrisë pagat në sektorin publik për 55 euro nga janari i vitit 2025. “Do të bëjmë një rritje substanciale të pagave në sektorin publik në fillim të vitit të ardhshëm, duke ruajtur qëndrueshmërinë afatgjatë të buxhetit dhe sipas ligjit në fuqi”, tha Kurti në një konferencë për medie. Ai theksoi se po e bën këtë për t’i mbështetur ata që kanë paga më të ulëta dhe për ta ngushtuar hendekun mes pagës më të ulët dhe asaj më të

lartë. “Ne kemi shkuar në maksimumin e lejuar të rritjes buxhetore për pagat dhe kemi vendosur të mos e rrisim vlerën e koeficientit, por ta rrisim koeficientin për një njësi. Pra, vlera e një koeficienti mbetet 110 euro. Mirëpo, rritet sasia e koeficienteve për njësi”, shpjegoi ai. Sipas Ligjit për Pagat, niveli i koeficienteve është nga 2 deri në 18. Niveli shumëzohet me vlerën dhe përcakton pagën. Qeveria do të mbajë takim të mërkurën ku pritet ta miratojë buxhetin e shtetit për vitin e ardhshëm, për të cilin Kurti tha se shpreson se ai do të gjejë mbështetje pastaj në Kuvend.

Në Komisionin për Ekonomi diskutohet për raportin vjetor të ARKEP-it

PRISHTINË, 29 TETOR - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, udhëhequr nga Jeta Statovci, nënkryetare, mbajti mbledhjen e radhës, me pikat e parapara për këtë rend dite. Në këtë mbledhje të pranishëm për të diskutuar rreth raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP, për vitin 2023 dhe për të dhënë sqarime më të detajuara, ishin përfaqësuesit e këtij institucioni. Sa iu përket aktiviteteve të realizuara, siç u tha në mbledhje, ndahen në dy kategori: aktivitetet kryesore, siç janë dhënia e resurseve në shfrytëzim për 20 vjet për

Telekomin e Kosovës dhe për Ipko Telecommunication, fuqizimi i mëtutjeshëm i të drejtave të konsumatorëve, duke i obliguar kompanitë për rritje të transparencës drejt konsumatorëve, hartimi i dokumenteve të nevojshme për procesin e varshmërisë së numrave etj. Ndërkaq sa iu përket aktiviteteve ditore, përfaqësuesit e ARKEP-it theksuan nënshkrimin e disa marrëveshjeve të reja për bashkëpunim me shtetet fqinje, siç janë Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali e Zi. Më pas, anëtarët e komisionit parashtruan pyetjet për përfaqësuesit e ARKEP-it, për të cilat u diskutua gjatë.



Konjufca pret në takim ministrin saudit të Haxhit dhe Umres në vizitën e tij të parë në Kosovë



PRISHTINË, 29 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim ministrin e Haxhit dhe Umres të Mbretërisë së Arabisë

Saudite, Tawfiq Al-Rabiah, ku ishin të pranishëm edhe ambasadori jorezident i Mbretërisë së Arabisë Saudite, Faisal bin Ghazi Hifzi, si dhe

kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnavi. Kryekuvendari Konjufca i uroi mirëseardhje ministrit Tawfiq Al-Rabiah në vizitën e tij të parë në

Republikën e Kosovës dhe shprehu nevojën e thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit mes dy vendeve. Në takim u bisedua për disa

çështje të interesit të përbashkët, duke përfshirë lehtësimin e udhëtimit të qytetarëve në të dy vendet dhe qarkullimin e mallrave apo shërbimeve, për nevojën e formimit të delegacioneve të bizneseve si një mekanizëm për ta nxitur rritjen e bashkëpunimit ekonomik, diskutuan rreth përfitimit nga përvojat dhe kapacitetet në fushën e IT-së, si dhe për bashkëpunimin që mundëson në mënyrë sa më optimale ushtrimin e jetës shpirtërore të qytetarëve.

Në këtë kontekst, Tawfiq Al-Rabiah informoi mbi platformën e-Visa të Arabisë Saudite, si infrastrukturë digjitale që lehtëson procedurat e vizitave, prej së cilës përfitojnë edhe personat që vizitojnë këtë vend për të ushtruar rite fetare të jetës shpirtërore dhe besimit.

Ai tha se Arabia Saudite, si në të kaluarën, do të vazhdojë ta mbështesë Republikën e Kosovës, me gatishmëri për të thelluar gjithnjë e më shumë marrëdhëniet e mira midis dy vendeve.

hapa), në mënyrë që të mundësohet përfshirja edhe brendapërbrenda kufirit buxhetor. Pra fillimisht rritja do të bëhet me gjysmë njësie të koeficientit nga janari, nga pagat e janarit, apo përkthyer në vlerë monetare 55 euro bruto për të gjithë të punësuarit. Kurse nga korriku hyn në fuqi edhe pjesa e dytë e rritjes, gjysma tjetër e koeficientit, për të rezultuar në një koeficient të plotë, pra 110 euro shtesë për secilin të punësuar në sektorin publik, rritje e pagës", ka thënë ministri Murati, duke shtuar se kjo është çfarë kanë arritur të bëjnë si

qeveri. "Besoj që është lajm tepër i mirë për të gjithë të punësuarit në sektorin publik, sepse kemi dëgjuar kohën e fundit që ka pasur premtime të paqëndrueshme dhe të pasakta e që nuk përkojnë as me realitetin buxhetor e as me ligjshmërinë dhe kornizën ligjore. Mirëpo kësaj, ne po arrijmë që, duke ndryshuar formulën e kalkulimit dhe formulën e rritjes, rritja të shpërndahet me tepër tek ata që kanë paga më të ulëta, si përqindje pra edhe mbi 20% deri në 25 apo 30% për disa raste specifike", ka deklaruar Murati.

Reagon opozita, rritjen e pagave e quan arnim

Përfaqësuesit e opozitës kanë reaguar pas lajmit të kryeministrit Kurti se do të rriten pagat në sektorin publik nga janari i vitit të ardhshëm. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka dhënë një premtim tjetër, që e tejkalon vendimin e qeverisë Kurti sa i përket rritjes së pagave. Sipas Abdixhikut, në javën e parë që ai vjen në qeveri, koeficienti do të bëhet 150 euro. "Po e përsëris, që

në javën e parë të qeverisjes sime, koeficienti i pagave do të bëhet 150 euro! Ndryshimi po vjen!", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook". Edhe anëtari i kryesisë së PDK-së, Arben Mustafa, ka reaguar ndaj paralajmërimit të kryeministrit Albin Kurti për rritjen e pagave të shërbësve publikë. Mustafa ka shkruar në "Facebook" se nuk përmirësohet standardi i jetesës duke u arnuar

me nga gjysmë koeficienti. "Qeveri e harrnimeve! Një qeveri që tërë mandatin e ka shpenzuar tu shpërnda lëmshë, po e përfundon mandatin duke premtuar vazhdim të lëmshës. Nuk përmirësohet standardi i jetesës duke u harrnuar me nga gjysmë koeficienti. Tani është koha të ecim përpara me kryeministrin Bedri Hamza, për përmirësim të vërtetë të jetës në Kosovë!", ka shkruar Mustafa.

Paraqitet skema e granteve, Peci: Jemi të angazhuar për t'i fuqizuar fermerët dhe sipërmarrësit tanë

Prishtinë, 29 tetor - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka marrë pjesë në hapjen e sesionit të parë informues të Skemës së Granteve 2024-2027. Ai ka thënë se ky projekt synon ta mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor në zonat rurale përmes agroturizmit dhe ekoturizmit. "Sot mbajtëm

sesionin e parë informues në komunën e Mitrovicës për ta prezantuar Skemën e Granteve në kuadër të projektit prej 20.2 milionë eurosh, i cili realizohet në partneritet me qeverinë gjermane dhe GIZ. Ky projekt synon ta mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor në zonat rurale përmes agroturizmit dhe ekoturizmit. Jemi të angazhuar

për t'i fuqizuar fermerët dhe sipërmarrësit tanë. Këtë e bëjmë duke ofruar mundësi investimi dhe mbështetje financiare. Sesionet informuese do të vazhdojnë në të gjitha komunat e Kosovës, duke siguruar që të gjithë të kenë qasje në informacion dhe mundësi për të përfituar nga skema", ka thënë ministri i Bujqësisë, Faton Peci.



Sindikatat ankohen për mosfunksionimin e Këshillit Ekonomiko-Social, IKD-ja paralajmëron padi ndaj MF-së

PRISHTINË, 29 TETOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin "Mungesa e kontratave kolektive - dështimi për të siguruar dialog social dhe mbrojtje kolektive të punëtorëve".

Naim Jakaj, hulumtues i lartë në IKD dhe autor i raportit, tha se mungesa e kontratave kolektive është duke dëmtuar të drejtat e punëtorëve në Kosovë. Ai tha se mbi 90 % e projektligjeve që lidhen me mbrojtjen sociale të punëtorëve, të planifikuara për miratim prej vitit 2021, nuk janë miratuar, siç janë Projektligji i Punës, Projektligji për Inspektoratin e Punës, Projektligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Jakaj u shpreh i shqetësuar edhe për mungesën e Këshillit Ekonomiko-Social (KES). Sipas tij, një organ kyç për dialogun social dhe mbrojtjen e punëtorëve në sektorin publik,

duke shtuar se përgjegjëse për mosformimin e KES është Ministria e Financave. Ai shpjegoi se mungesa e KES-it pengon mundësinë e punëtorëve për t'i negociuar kushtet e punës dhe arrijen e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Sipas tij, nëse Ministria e Financave nuk ndërmer hapa për funksionimin e KES-it, IKD-ja do ta padisë këtë ministri. "Me ardhjen në pushtet ata kaluan në një qasje krejtësisht tjetër, duke nisur një luftë ndaj rolit sindikal dhe duke dëmtuar këtë bashkëpunim të rëndësishëm. Sindikatat dhe përfaqësuesit e tyre ishin cak i sulmeve të vazhdueshme si nga kryeministri Kurti, ministri Murati dhe eksponentë të partisë në pushtet. Aktualisht në Kosovë nuk ka një punëtor që mbrohet nga kontratat kolektive, gjë që është një situatë e pashembullt



dhe tepër shqetësuese", theksoi ai, duke shtuar se kjo gjendje pengon ndjeshëm sigurinë dhe drejtësinë sociale në vend. "Ligji aktual për punën është i pamjaftueshëm për t'iu përgjigjur sfidave të reja në tregun e punës, dhe kjo është arsyeja që sot kemi një numër të madh të çështjeve

gjyqësore nga punëtorët që kërkojnë drejtësi për të drejtat e tyre. Tërheqja nga Kontrata Kolektive në mënyrë të njëanshme dhe pa paralajmërim nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dhe, në

anën tjetër, tërheqja nga Kontrata Kolektive në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Shëndetësisë, përbëjnë cenim të të drejtave sociale të garantuara me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe sipas standardeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Pasojat e mosformimit të KES-it janë të shumta dhe të ndjeshme. Pa një KES funksional, punonjësit nuk kanë një entitet juridik të përfaqësimit për të diskutuar dhe negociuar për kushtet e punës dhe të drejtat e tyre", ka thënë Jakaj.

Atdhe Hykolli, kryetar i BSPK-së, tha se me kërkesat e tyre për funksionimin e KES-it duan që vetëm të zbatohet ligji.

Rrahman Jasharaj, kryetar i SBASHK-ut, tha se me qasjen e qeverisë karshi sindikatave, me mungesën e kontratës kolektive dhe të dialogut social, Kosova është një vend me demokraci jo të plotë.

Projektligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore merr përkrahjen e Komisionit për Arsim



PRISHTINË, 29 TETOR - Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, udhëhequr nga kryetari Ardiyan Gola, mbajti mbledhjen e radhës, në të cilën u shqyrtuan në parim dy projektligje.

Gjatë kësaj mbledhjeje i pranishëm ishte edhe ministri për Kulturë, Rini dhe Sport, Hajrulla Çeku, i cili e paraqiti dhe arsyetoi Projektligjin për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore përmes

të cilit, siç theksoi ministri, do të themelohet Inspektorati Qendror i Trashëgimisë Kulturore si agjenci ekzekutive, duke mundësuar përmirësimin e kushteve të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në vend.

Pas shqyrtimit Komisioni i dha mbështetje të plotë këtij projektligji, duke e proceduar tutje për shqyrtim të mëtejshëm në Kuvend. Ministri Çeku, po ashtu, e

paraqiti dhe arsyetoi edhe Projektligjin Kundër Dukurive Negative në Sport. Ministri Çeku theksoi se ky projektligj do të ketë efekt të drejtpërdrejtë në minimizimin e dukurive negative në sport si dhe do të kontribuojë si një aktivitet shoqëror, edukues dhe kulturor, që ndikon edhe në shëndetin dhe mirëqenien e sportistëve. Ky projektligj mori përkrahjen e anëtarëve të komisionit për procedim të mëtejshëm në Kuvend.

Osmani në turqisht uron Erdoganin për Ditën e Republikës: Jemi të vendosur ta forcojmë partneritetin tonë

Prishtinë, 29 tetor - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka uruar homologun turk, Recep Tayyip Erdogan, me rastin e Ditës së Republikës. Në "X", Osmani ka uruar që fryma e unitetit dhe solidaritetit të mbizotërojë në Turqi. "I nderuar president Erdogan, në këtë ditë të rëndësishme kur populli turk

feston Ditën e Republikës, ju uroj që fryma e unitetit dhe solidaritetit të mbizotërojë në të gjithë vendin tuaj", ka shkruar Osmani.

Presidentja ka shprehur falënderimet për mbështetjen e palëkundur të Turqisë për Kosovën. "Populli i Kosovës i shpreh falënderimet e sinqerta

Turqisë për mbështetje të palëkundur dhe miqësi të vazhdueshme gjatë këtyre viteve. Jemi të vendosur ta forcojmë më tej partneritetin tonë dhe shpresojmë të shfrytëzojmë me entuziazëm mundësitë që ofron bashkëpunimi ynë", ka shkruar Osmani.



Kosova dhe Arabia Saudite, marrëveshje për nisjen e linjave ajrore direkte

PRISHTINË, 29 TETOR - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, së bashku me Ali Bin Mohammed Rajab, zëvendës-president ekzekutiv për Transportin Ajror dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar nga Autoriteti i Përgjithshëm i Aviacionit Civil, kanë nënshkruar marrëveshjen për

shërbime ajrore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite. Me këtë rast, Aliu tha se kjo marrëveshje është me rëndësi të veçantë për aviacionin civil, e cila krijon mundësinë për nisjen e linjave ajrore direkte ndërmjet të dy vendeve.

Ali Bin Mohammed Rajab, zëvendës-president ekzekutiv

për Transportin Ajror dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar nga Autoriteti i Përgjithshëm i Aviacionit Civil, tha se marrëveshja mundëson udhëtimin e qytetarëve, qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve si dhe ta nxisë zhvillimin e biznesit në të dyja vendet në mënyrë sa më efikase.

Ceremonia e nënshkrimit u realizua në prani të delegacionit të lartë shtetëror të Mbretërisë së Arabisë Saudite, të prirë nga ministri për Haxh dhe Umrah Tawfig Fawazan Alrabiah, bashkë me zëvendësministrin dhe zyrtarë të tjerë të lartë shtetërorë sauditë të cilët po qëndrojnë për një vizitë në Kosovë për t'i "forcuar edhe më



tejt raportet e shkëlqyera ndërshtetërore me nisma dhe marrëveshje të ndryshme në interes të të dyja vendeve".

'Volkswagen'-i do t'i mbyllë tri fabrika në Gjermani

BERLIN, 29 TETOR - "Volkswagen"-i i ka njoftuar përfaqësuesit e punëtorëve se dëshiron t'i mbyllë të paktën tri fabrika në Gjermani, tha të hënën kryetarja e këshillit të punëtorëve të kompanisë, Daniela Cavallo. Cavallo tha në një takim me punëtorët e "Volkswagen"-it në selinë e kompanisë në "Volfburg" se menaxhmenti ka për qëllim t'i shkurtojë vendet e punës në fabrikat e tjera, raportojo agjencia gjermane e lajmeve, DPA.

Ajo tha se "të gjitha fabrikat e VW janë të prekura nga këto plane. Askush nuk është i sigurt".

Kompania nuk ka dhënë hollësi

rreth planeve të saj. Por, shefi i personelit, Gunnar Kilian, tha në një komunikatë se "fakti është se gjendja është serioze dhe përgjegjësia e partnerëve negociuese është jashtëzakonisht e madhe", raportojo DPA.

"Volkswagen"-i tha në fillim të shtatorit se ndryshimet në industrinë e automjeteve nënkuptojnë se kompania nuk e përjashton mundësinë e mbylljes së fabrikave në vend dhe se do të detyrohet të heqë dorë nga zotimi për mbrojtjen e vendeve të punës, i cili ka qenë në fuqi prej vitit 1994 dhe pritej të mbetej i tillë deri më 2029.



Shefi ekzekutiv i "Volkswagen"-it, Oliver Blume, i përmendi konkurrentët, përkeqësimin e pozicionit të Gjermanisë si vend

prodhues dhe nevojën për të "vepruar në mënyrë vendimtare". "Pa masa gjithëpërfshirëse për ta kthyer

konkurrencën, ne nuk do të jemi në gjendje të bëjmë investime të mëdha në të ardhmen", tha Kilian.

Prodhuesit evropianë të automjeteve janë duke u përballur me konkurrencë të madhe nga veturat elektrike kineze që kushtojnë lirë.

"Volkswagen"-i tha muajin e kaluar se rezultatet gjashtëmujore të kompanisë tregojnë se ajo nuk do ta arrijë cakun e saj prej 10 miliardë eurosh për ruajtjen e shpenzimeve deri në vitin 2026.

"Volkswagen"-i i ka 120 000 punëtorë në Gjermani në dhjetë 10 fabrika.

ZKA-ja dhe KLSH-ja angazhohen për përmirësimin e auditimit publik në Kosovë dhe Shqipëri

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 TETOR - Auditorja e përgjithshme e Republikës së Kosovës, Vlora Spanca, ka pritur në vizitë kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, Arben Shehu, me bashkëpunëtorë. Takimi me drekë pune pati për qëllim diskutimin gjithëpërfshirës të temave me interes të përbashkët në shërbim të përmirësimit të auditimit publik në Kosovë dhe Shqipëri.

Auditorja e përgjithshme Vlora Spanca vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me Shehun dhe



KLSH-në si dhe shprehu përkushtimin e saj dhe të ZKA-së për forcimin e mëtejshëm të këtij

bashkëpunimi vëllazëror dhe institucional. Ajo theksoi se puna e përbashkët përgjatë këtyre tri

viteve ka qenë model frymëzues i solidaritetit dhe përkushtimit ndaj transparencës dhe llogaridhënies publike. "Takimi jonë sot, përveçse është një mundësi e mirë për t'i ndarë përvojat tona profesionale, përfaqëson edhe një çast për t'i forcuar lidhjet tona miqësore dhe institucionale. Ndërveprimi i vazhdueshëm në mes të KLSH-së dhe ZKA-së prodhoi rezultate të prekshme dhe ngriti standardet e punës tonë. Punuam së bashku për t'i avancuar kapacitetet profesionale për të siguruar që qytetarët tanë të kenë institucione më të përgjegjshme dhe shërbime më cilësore", ka

deklaruar Spanca.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), Arben Shehu, shprehu mirënjohjen për pritjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm. Ai tha se takimet e tilla janë gjithmonë të mirëseardhura sepse i shërbejnë forcimit të lidhjeve tona të veçanta dhe punës profesionale me qëllim të përmirësimit të punës audituese dhe rritjes së rezultateve në të dy vendet. Përveç diskutimeve profesionale, delegacionet realizuan një vizitë kulturore në qytetin e Prizrenit për të njohur më afër pjesë të rëndësishme të historisë së përbashkët të dy vendeve.

AKB-ja shënon 22-vjetorin e themelimit, Shahini: Mision kemi rritjen e prodhimit vendor

PRISHTINË, 29 TETOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka shënuar 22-vjetorin e themelimit. Kryetari i saj, Agim Shahini, ka thënë se këto 22 vjet kanë qenë të vështira, me sfida e me plot pengesa. Mirëpo Shahini ka theksuar se rrugëtimi i AKB-së nuk ka qenë vetëm mandat, por edhe mision për ta zhvilluar ekonominë e Kosovës. "Në 22-vjetorin e udhëtimit tonë të përbashkët me ju, në emër të AKB-së ne po ecim bashkë tash e 22 vjet. Udhëtimi ynë nuk është mandat por mision, e cila

do të fokusohet në rritjen e zhvillimit ekonomik të vendit, mbi të gjitha, rritjen e prodhimit vendor. Gjatë 22 viteve patëm suksese të njëpasnjëshme, por ende misionin nuk e kemi realizuar. Misioni ynë është ta zhvillojmë dhe ta rrisim prodhimin vendor. Do të duhet të rritet vetëdija kombëtare për prodhimet vendore", ka thënë Shahini, duke theksuar se rrugëtimi i AKB-së nuk ka qenë i lehtë. "Ne sot e kemi tavolinën plot, me bizneset bashkëthemeluese, njerëz që vijnë nga biznesi, politika,

kultura dhe sporti", ka pohuar ai. Shahini i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të dialogojë me AKB-në në mënyrë që të rritet zhvillimi ekonomik. "Fuqizimi ekonomik nuk vjen nga deklaratimet e thata. Ftesa jonë është, të gjithë këtu që jemi dhe ata që na dëgjojnë të bashkëpunojnë mendjen dhe ta zhvillojmë ekonominë e vendit, sepse është e vetmja shpresë për të qenë shtet qysh dëshirojmë. Kosova ka arritur shumë, por jo në arritjet e dëshirueshme", ka thënë Shahini.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



KB Vëllaznimi emëron trajner të ri Jeronimo Sarinin

GJAKOVË, 29 TETOR - KB Vëllaznimi e ka emëruar trajner të ri Jeronimo Sarin. Ky i fundit debutoi me fitore të madhe në ndeshjen ndaj Prishtinës në kryeqytet me rezultat 85:101 (23:24, 15:26, 21:23, 26:28). "Të hënën debutoi me fitore të madhe trajneri i ri i ekipit tonë,

Jeronimo Sarin, i cili do ta udhëheqë skuadrën në vazhdim të edicionit. Trajnerit i urojmë mirëseardhje në ekip dhe suksese në arritjen e qëllimeve tona", thuhet në njoftimin e Vëllaznimit. 50-vjeçari nga Shibeniku është emër i njohur për basketbollin

e Kosovës pasi në të kaluarën ka drejtuar edhe skuadra të tjera në vendin tonë, ku fillimisht me Prishtinën në vitin 2017 e fitoi titullin e kampionit dhe Kupën e Kosovës, pastaj në vitin 2019 punoi te Bashkimi e në po të njëjtin vit drejtoi edhe ekipin e Pejës.

Sarin ka punuar trajner edhe në Turqi, Poloni, Belgjikë, Francë, Austri, Republikë Çeke, si dhe në vendlindje në Kroaci, duke drejtuar disa skuadra. Pikërisht ekipi i fundit që ka drejtuar, ka qenë Dubrava nga Kroacia, ku punoi për tri edicione dhe tregoi rezultate shumë të mira.



Balkani ndalet në barazim nga Gjilani, sot zhvillohen dy ndeshje

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 TETOR - Gjashtë gola janë shënuar në ndeshjen e parë të javës së 11-të në elitën e futbollit kosovar në mes të Ballkanit dhe Gjilanit (3-3). Pjesa e parë ishte shumë interesante ku u shënuan tre gola. Në minutën e pestë Lindon Emërllahu i kaloi vendasit në epërsi, por dhjetë minuta më vonë Armend Thaqi ndëshkon ish-skuadrën për rezultatin 1-1. Në fund të pjesës së parë Edi Basha kaloi për herë të parë mysafirët në epërsi 1-2, derisa

pjesa e dytë solli edhe tre gola të tjerë. Pas një ore lojë, Giovanni Riberiero barazoi rezultatin në 2-2. Tetë minuta para fundit të ndeshjes Bernard Karrica realizoi golin e tretë për Ballkanin, që kaloi për herë të dytë në epërsi. Gjilani nuk u dorëzua dhe arriti ta barazojë rezultatin në 3-3, kur Armend Thaqi realizoi golin e dytë personal në minutat shtesë të ndeshjes. Pas kësaj ndeshje, Ballkani vazhdon të jetë në pozitën e parë me 19 pikë, kurse Gjilani është në kuotën e 13 pikëve dhe zë vendin e shtatë në renditjen tabelore. Xhiroja e 11-të vazhdon sot (e mërkurë) me



dy ndeshje të tjera. Dukagjini, që në fundjavë e ndali Ballkanin në barazim, e pret skuadrën e

Suharekës, nga e cila ndeshje synon të marrë fitore. Në anën tjetër edhe suharekasit kanë synime të mëdha në këtë ndeshje ashtu sikurse në ndeshjet e kaluara. Në ndeshjen tjetër përballen Llapi dhe Feronikeli 74. Vendasit që drejtohen nga Tahir Batatina janë favoritë në këtë ndeshje dhe synojnë këndelljen pas humbjes në xhiron e kaluar nga Gjilani. "Nikli" është në vendin e fundit në renditjen tabelore dhe do të përpiqet të shkaktojë befasi në Drenas. Të enjten zhvillohen dy ndeshjet e fundit për këtë xhiro, derisa zhvillohet derbi në mes të

Dritës dhe Prishtinës. Ndërkohë në ndeshjen tjetër përballen Ferizaj dhe Malisheva. Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 13:00.

SUPERLIGA

Ballkani-Gjilani 3-3

Të mërkurën takohen: Dukagjini - Suhareka Llapi - Feronikeli 74

Të enjten takohen: Drita - Prishtina Ferizaj - Malisheva

Kapiti, MVP i javës së shtatë në Superligë

PRISHTINË, 29 TETOR - Dardan Kapiti është lojtari më i mirë i javës së shtatë të ProCredit Superligës. Qendra e Kosovës tregoi një paraqitje shumë të mirë përballë Borës, duke mbyllur ndeshjen me dyshifror të dyfishtë, 18 pikë e 15 kërcime. Kapiti shtoi edhe dy asistime, dy topa të vjedhur dhe tri bllokada, duke pasur indeksin 30, apo më të lartën e kësaj xhiro. Terrell Brown vazhdon të tregojë ndeshje të mira me Golden Eagle Yllin. Brown ndaj Proton Cable Prizrenit e mbylli ndeshjen me 24 pikë, tri kërcime dhe katër asistime. Ai pati ndihmë të madhe nga Gëzim Morina, që zhvilloi një sfidë mjaft të mirë përballë prizrenasve me 16 pikë, pesë kërcime dhe katër asistime, duke hyrë në top 5 e javës. Vëllaznimi shënoi fitore në kryeqytet ndaj Sigal Prishtinës, ku



më i miri te kuqezinjtë ishte Trey Anderson me 22 pikë, gjashtë kërcime dhe një asistim. Derbin e kësaj xhiroje e fitoi Bashkimi ndaj Pejës, ku prizrenasit vazhdojnë të jenë skuadra e vetme pa humbje me shtatë fitore në shtatë ndeshje, ndërsa të prizrenasit më i miri ishte Lejson

Zeqiri, i cili kishte 18 pikë, pesë kërcime e dy asistime.

MVP

Dardan Kapiti (Trepça) 18 pikë, 15 kërcime, 2 asistime, 30 indeksi

Top pesëshja

Dardan Kapiti (Trepça) 18 pikë, 15 kërcime, 2 asistime, 30 indeksi
Terrell Brown (Golden Eagle Ylli) 24 pikë, 3 kërcime, 4 asistime, 27 indeksi
Trey Anderson (Vëllaznimi) 22 pikë, 6 kërcime, 1 asistim, 27 indeksi
Gëzim Morina (Golden Eagle Ylli) 16 pikë, 5 kërcime, 4 asistime, 20 indeksi
Lejson Zeqiri (Bashkimi) 18 pikë, 5 kërcime, 2 asistime, 19 indeksi

Çerekfinalet e Kupës priten me spektakël, përballen Peja dhe Sigal Prishtina

PRISHTINË, 29 TETOR - Të martën është bërë tërheqja e shortit konform propozicioneve të garave për Kupën e Kosovës të meshkujt, sipas sistemit të Bergerit dhe në bazë të renditjes pas shtatë xhironë të zhvilluara në kuadër të ProCredit Superliga. Në ndeshjet çerekfinale ndeshen skuadrat 1-8, 2-7; 3-6 dhe 4-5. Si nikoqir në ndeshjet e para do të luajnë skuadrat më poshtë të renditura në momentin e tërheqjes së shortit, kurse në ndeshjet e kthimit si nikoqir do të luajnë skuadrat më lart të renditura. Në bazë të renditjes, Bora e fundit do të ndeshet me liderin Bashkimin, kurse Proton Cable Prizreni do të përballlet me fituesen aktuale Trepçën. Çerekfinalja do të



dhurojë spektakël në sfidën e rivalëve të vjetër, Pejës dhe Sigal Prishtinës, që duan kalimin në gjysmëfinale. Takim, po ashtu, interesant shihet në mes të Vëllaznimit dhe Golden Eagle Yllit.

Çiftet çerekfinale të Kupës së Kosovës
Bora - Bashkimi
Proton Cable Prizreni - Trepça
Peja - Sigal Prishtina
Vëllaznimi - Golden Eagle Ylli

Short i vështirë për Rahovecin

RAHOVEC, 29 TETOR - Rahoveci do të ketë punë të vështirë në raundin e tretë të Kupës Evropiane për hendbollistë. Shorti i tërhequr të martën në Vjenë ka përcaktuar që Rahoveci të luajë me skuadrën e njohur

rumune Minaur Baia Mare. Kjo skuadër në edicionin e kaluar arriti deri në gjysmëfinale të Kupës Evropiane. Në vitin 2022 ishte në finale. Minaur Baia Mare ka përvojë të gjatë e të suksesshme në gara

kontinentale. Ndërkohë liga rumune vlerësohet shumë e fortë, por "vreshtarët" janë të përkushtuar për paraqitje sa më të mirë dhe për të kërkuar tjetër sukses historik. Ndeshja e parë është më 23 apo

24 nëntor në Rahovec, ndërsa e kthimit një javë më pas në Rumani. Rahoveci për herë të dytë paraqitet në gara evropiane. Në raundin e dytë e eliminoi skuadrën belge Bocholt.



Verstappen: Nuk e ndryshoj stilin tim të pilotimit, herën tjetër të më penalizojnë më shumë

HASSET, 29 TETOR - Rivaliteti mes Max Verstappenit (Red Bull) dhe Lando Norrisit (McLaren) u spostua nga Amerika në Meksikë dhe me shumë gjasë do të vijojë deri në garën e fundit sezonale. Nëse në Amerikë komisarët penalizuan me 5 sekonda britanikun e McLarenit, në Meksikë ndodhi e

kundërta, me holandezin që u penalizua 20 sekonda. Kjo bëri që tri herë kampioni i botës në Formula 1 ta përfundojë garën në vendin e gjashtë dhe tashmë ka 47 pikë avantazh karshi Norrisit. Duke komentuar atë penalitet të dyfishtë (2 herë nga sekonda), Verstappen ka thënë: "Nuk kam çfarë të them.

Qëndrimi i palëvizshëm për 20 sekonda në pit-stop është vërtet një kohë e gjatë". "Problemi më i madh në garë ishte se nuk kishim ritëm. Kam vuajtur shumë me gomat. Ne nuk ishim në të njëjtën kategori si Ferrari dhe McLaren", ka shtuar Verstappen, që kërkon edhe mbështetjen e skuadrës për ta

mbrojtur avantazhin që ka ndaj Norrisit në renditje. Në lidhje me incidentet në pistë, ai ka deklaruar: "Nuk do ta ndryshoj mënyrën time të pilotimit. Herën tjetër do të sigurohem të kem diçka për të pirë në pit-stop. Sezoni ka ulje-ngritje, disa javë janë më të mira se të tjerat. Thjesht duhet të vazhdojmë të



punojmë për ta bërë makinën sërish konkurruese".

Bostoni dhe Oklahoma, 'poker' fitoresh në Lindje, humbja e parë sezonale për lakersat

BOSTON, 29 TETOR - Boston Celtics vijon të jetë i pamposhtur në NBA, duke korrur fitoren e katërt radhazi. Kampionët mundën me rezultat 119-108 rivalët e Milwaukee, në një ndeshje të dominuar prej tyre. Kolektiviteti i Bostonit bëri diferencën, me 6 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë (Brown 30 pikë). Për Bucksin, Lillard me 33 pikë e Antetokounmpo me 30 nuk



mjaftuan për të fituar. Me katër fitore edhe ekipi i Clevelandit, që fitoi me rezultat 110-104 në fushën e New Yorkut. Garlandi me 34 pikë ishte lider për Cavaliersin. Humbjen e parë sezonale e pësoi skuadra e lakersave, që u mund me rezultat 109-105 nga Phoenixi. Sfidë e ekuilibruar, ku dyshja Booker - Durant realizoi 63 pikë së

bashku për Suns. Fitore të vështirë jashtë fushës korri Chicago, që mundi me rezultat 126-123 Memphis (LaVine 30 pikë). Fitorja e parë sezonale për Denverin, që mundi në kohën shtesë Toronton me rezultat 127-125. Jokiçi me 40 pikë e 10 rebounde ishte shënuesi më i mirë për miqtë.

REZULTATET

Orlando - Indiana	119-115
Atlanta - Washington	119-121
Boston - Milwaukee	119-108
Miami - Detroit	106-98
New York - Cleveland	104-110
Toronto - Denver	125-127
Memphis - Chicago	123-126
San Antonio - Houston	101-106
Dallas - Utah Jazz	110-102
Phoenix - Lakers	109-105
Sacramento - Portland	111-98

Fury: Gruaja ime pati abort një ditë para duelit me Usykun

LONDËR, 29 TETOR - Tyson Fury ka zbuluar se u prek nga një fatkeqësi personale një ditë para sfidës me Oleksandr Usyk në maj të këtij viti. Bashkëshortja e tij Paris Fury ishte gjashtë muajsh shtatzënë, priste një djalë, por ajo abortoi një ditë para "Gypsy King" të duelonte ndaj ukrainasit në Ryad të Arabisë Saudite. Fury mësoi për abortin e gruas së tij kur ai u kthye në shtëpi, një ditë para duelit, ku u mund dhe humbi titullin kampion bote në peshën e rëndë (kategoria WBC). Kjo ishte edhe humbja e parë e boksierit britanik në karrierën e tij. Tashmë palët përgatiten për revanshin, më 21 dhjetor të këtij viti. Fury foli për këtë temë për herë të parë në konferencën për shtyp: "Fëmija që ajo kishte, e humbi të premtën e duelit. Ajo ishte në muajin e gjashtë shtatzënë, ndaj nuk ishte e



lehtë. Duhet të lindësh fizikisht një fëmijë të vdekur, vetëm, ndërsa bashkëshorti yt është në një vend të huaj dhe gati për sfidë. Të kalosh vetë këtë nuk është mirë". "Unë nuk mund të isha aty me Paris në atë moment. Dhe kjo ishte e vështirë për mua. Unë kam qenë me gruan gjatë gjithë kohës, por jo në atë moment, kështu që ishte një moment tronditës. Kur ajo tha se nuk mund të vinte, e dija se kishte një problem. Ajo

zakonisht vjen në javën e luftimeve, por tha se kishte presion të lartë të gjakut", ka deklaruar Fury. "Turki Alalshikh na ofroi një avion privat dhe tha se mund të sillte mjekun me vete, por Paris tha se nuk mund të vinte. E pyeta se çfarë ishte dhe i kërkova të më tregonte, por ajo nuk donte. Kështu që e dija se kishte një problem. Ajo kurrë nuk më tha se e kishte humbur fëmijën, por unë e dija. Kur u ktheva mora konfirmimin e pashmangshëm", thotë Tyson Fury. Më tej, Fury ka shtuar: "Ky nuk është një justifikim për humbjen. Unë jam një njeri i nderit. Unë bëj atë që duhet të bëj kur jam në ring. Nuk mendoj për gjëra të tilla kur jam në ring. Asgjë jashtë ringut nuk ka rëndësi në atë moment, nuk ka asnjë emocion. Mendoni për të gjitha ato gjëra më pas".

SHKURT

Vinicius reagon fuqishëm pasi nuk e fitoi 'Topin e Artë'

Superylli i Real Madridit, Vinicius Junior, nuk e ka fituar "Topin e Artë" 2024, ndonëse deri në fund ishte favoriti kryesor. Ai e humbi garën me mesfushorin spanjoll Rodri, i cili e fitoi këtë çmim për herë të parë në karrierë. I menjëhershëm qe reagimi i Vinicius Junior në rrjetin social "X". "Nëse është nevoja do ta bëj edhe 10 herë të tjera. Ata nuk janë gati", ka shkruar Vini. Rodri u bë lojtari i parë nga Premierë Liga që e fitoi këtë çmim që nga koha e Cristiano Ronaldos më 2008.

Barcelona synon ta blindojë Yamalin me një kontratë afatgjatë

Barcelona është e vendosur ta rinovojë vitin e ardhshëm kontratën e yllit spanjoll, Lamine Yamal, duke siguruar të ardhmen e tij afatgjatë në klub. Marrëveshja aktuale e 17-vjeçarit zgjat deri në vitin 2026, por katalanasit kanë arritur tashmë një marrëveshje me Yamalin dhe agjentin e tij, Jorge Mendes. Marrëveshja në mes të palëve thuhet se është arritur për ta zgatur kontratën e spanjollit deri në vitin 2030, pasi ai të mbushë 18 vjeç. Mendes u takua me presidentin e Barcelonës, Joan Laporta dhe drejtorin sportiv Deco në fillim të këtij muaji për të diskutuar për rinovimin. Klubi synon ta konfirmojë zyrtarisht kontratën e re të Yamal vitin e ardhshëm, e cila pritet të përfshijë përmirësime të konsiderueshme në pagën e tij. Edhe klauzola pritet të përfshihet në kontratë dhe ajo nuk pritet të jetë më e vogël se 1 miliard euro.

Ndërron jetë skiatorja 19-vjeçare Matilde Lorenci

Një prej skiatoreve më premtuese italiane ka ndërruar jetë në spitalin e Bolcanos, "San Maurizio". Dëmtimet e pësuar në aksidentin që pësoi gjatë stërvitjes në luginën Val Senales kanë qenë fatale për 19-vjeçaren. Lajmin e hidhur e dha ministri i Mbrojtjes, Guido Kroseto, i cili në platformën "X" shkroi: "Ngushëllimet më të thella familjes dhe kolegëve të Matilde Lorenci, sportiste ushtarake dhe skiatore premtuese italiane, e cila u nda nga jeta tragjikisht".

Kane: Dua të qëndroj edhe për shumë vjet në Bayern

Harry Kane ka fituar trofeun "Gerd Muller 2024", që i jepet lojtarit që shënoi më shumë gola në sezonin 2023-2024, në ceremoninë e "Topit të Artë" në Paris. Sulmuesi anglez ka deklaruar se synon të qëndrojë sa më gjatë në Mynih, me objektivin e qartë: të shënojë sa më shumë gola dhe të fitojë sa më shumë trofe. "Më duhet ta falënderoj Bayernin dhe 'France Football' që më votuan këtë mbrëmje. Ky çmim mban emrin e një legjende të klubit tim dhe kjo më bën edhe më krenar. Kalimi nga Tottenhami te Bayerni ishte një përvojë e re për mua dhe familjen time. Dua t'i falënderoj shokët e mi. Shpresoj se mund të vijmë më shumë gola dhe suksese. Unë jam duke mësuar gjermanisht. Shpresoj të qëndroj edhe për disa vjet dhe të bëj edhe më mirë", ka thënë Kane.

Liverpooli e sheh Adeyemin si zëvendësues të Salahut

Pavarësisht se e ka shprehur haptazi besnikërinë e tij ndaj "Të Kuqve" të Liverpoolit, sërish mosha bën të vetën dhe së shpejti në "Anfield" mund të mbërrijë një zëvendësues për "faraonin" Mohamed Salah.

Sipas raportimeve më të fundit të prestigjiozes gjermane "Bild", mes shumë emrave të kërkuar nga tekniku Arne Slot është edhe "ylli" gjerman i "Verdhezinjve" te Borussia Dortmund, Karim

Adeyemi, me 22-vjeçarin që i skadon kontrata në fund të këtij sezoni dhe një kalim në Premierë Ligë nuk përjashtohet. Megjithatë, duket se Liverpooli kërkon të sigurojë më shpejt shërbimet

e "pistonit" të sulmit, teksa është gati të paguajë që në merkaton e dimrit plot 50 milionë euro për kartonin e tij. Ndërkaq, kujtojmë se Karim Adeyemi ka pasur një nisje fantastike të këtij sezoni, teksa

në tetë sfidat e para, në Bundesliga, Ligën e Kampioneve dhe Kupën e Gjermanisë ka arritur të shënojë plot pesë gola, si dhe të asistojë në pestë raste të tjera shokët e tij të skuadrës.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

FTESË PËR OFERTË FURNIZIM DHE SHËRBIM

Konform udhëzuesit të brendshëm për prokurim Nr 17-2023 për Autoritetin e likuidimit mbi procedurat e prokurimit duke shfrytëzuar fondet e likuidimit në mirëbesim

Data: 30.10.2024

I: **AUTORITETI KONTRAKTUES:** Agjencia Kosovare e Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit, ZR Prishtinë, ZR Pejë, ZR Prizren, ZR Gjilan dhe ZR Mitrovicë

NENI II: QËLLIMI I KONTRATËS

II.1 **Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:** *Bartja e dokumentacionit të vlershëm të NSH-ve në Likuidim - regjionit të Prishtinës, Prizrenit, regjionit të Pejës, regjionit të Mitrovicës dhe regjionit të Gjilanit, në Arkivat përkatëse*

II.2 Lloji i kontratës dhe lokacioni i dorëzimit:

Bartja e dokumentacionit të vlershëm të NSH-ve në Likuidim - regjionit të Prishtinës, Prizrenit, regjionit të Pejës, regjionit të Mitrovicës dhe regjionit të Gjilanit, në Arkivat përkatëse.
Lokacioni i dorëzimit është në AKP, ZQ Prishtinë - Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, 10.000 Prishtinë.

NENI III: KËRKESAT të cilat duhet të përmbushen nga OPERATORET EKONOMIK

IV.1 AFATI KOHOR PËR KËRKESAT E INFORMACIONEVE SHITESË OSE SQARUESE

IV.2 KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS

Oferta e përgjegjshme me çmim më të ulët

IV.2 Afati kohor për pranimin e tenderëve: më së voni më 14 Nëntor 2024 koha: 14:00.

IV.3 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 14 Nëntor 2024 Koha: 14:30:00 Vendi: Objekti e AKP-së, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, 10.000 Prishtinë

- Tenderuesit fitues dhe apo/eliminues do të njoftohen përmes emailit
- Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur dhe të vulosura. Shikoni me kujdes kushtet të cilat duhet ti plotësoni.

Kërkesa për dosjen e tenderit: Dosja e tenderit mund të shkarkohet në webfaqen www.pak-ks.org.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kujtim Doli B.I nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër UNIK: 80054122 të lëshuar nga ARBK-ja.

- Leonard Gjuraraj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollë së mesëm teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Jetmir Malushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA 1992

